

VENDIM
Nr. 717, datë 12.10.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 19, DATË 14.1.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN,
TRANSFERIMIN DHE PËRSËRITJEN E LICENCËS SË KONCESIONIT PËR
RAFINERI PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SË PËRPUNIMIT TË NAFTËS
BRUTO PËR PRODHIMIN E NËNPRODUKTEVE TË SAJ”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, pika 2, e 18, pika 3, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 19, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në kapitullin II, “Kushtet dhe procedurat për pajisjen me miratim paraprak”, pika 1.11 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1.11. Vlerën e bonusit vjetor të trajnimit që ofron personi juridik për stafin e ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet dhe organet e saj të varësisë, në rastin e pajisjes me licencë koncesioni për rafineri.”.

2. Në kapitullin III, “Procedurat për pajisjen me licencë koncesioni për rafineri”, pika 6 ndryshohet si më poshtë vijon:

“6. a) Dhënia e licencës së koncesionit për rafineri për ndërtimin e rafinerisë për përpunimin e naftës bruto dhe funksionimin e saj bëhet sipas klasifikimit të mëposhtëm, kundrejt një pagese prej:

- 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh për rafineri me kapacitet përpunimi deri në 100 000 tonë;
- 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh për rafineri me kapacitet përpunimi nga 100 000 tonë deri në 200 000 tonë;
- 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh për rafineri me kapacitet përpunimi nga 200 000 tonë deri në 300 000 tonë;
- 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh për rafineri me kapacitet përpunimi mbi 300 000 tonë.

b) Pagesat e përcaktuara në shkronjën “a”, të kësaj pike, bëhen nga subjekti, mbajtës i lejes, në llogarinë e institucionit. Të ardhurat e përfituara nga pagesat derdhen në buxhetin e shtetit.”.

3. Në kapitullin V, “Procedurat për përsëritjen e licencës së koncesionit për rafineri”, pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Përsëritja e licencës së koncesionit për rafineri bëhet sipas klasifikimit të mëposhtëm, kundrejt një pagese që derdhet në buxhetin e shtetit, prej:

- 5 000 000 (pesë milionë) lekësh për rafineri me kapacitet përpunimi deri në 100 000 tonë;
- 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh për rafineri me kapacitet përpunimi nga 100 000 tonë deri në 200 000 tonë;
- 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh për rafineri me kapacitet përpunimi nga 200 000 tonë deri në 300 000 tonë;
- 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekësh për rafineri me kapacitet përpunimi mbi 300 000 tonë.”.

4. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi